



KAPITULLI

23

GJYQËSORI DHE TË
DREJTAT THEMELORE

Dëftesa E Progresit Dhe Nivelit Të Përgatitjes Së Shqipërisë Drejt Anëtarësimit Në Bashkimin European 2023–2024

Ky punim u përgatit nga Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) në kuadër të projektit “Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri”, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian nëpërmjet Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e autorëve dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri (QKB), është një iniciativë e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim zbatuar në partneritet me Qendrën Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (ACPD) dhe Lëvizjen Europiane në Shqipëri (EMA).

nëntor 2024, Tiranë

Dëftesa E Progresit Dhe Nivelit Të Përgatitjes Së Shqipërisë Drejt Anëtarësimit Në Bashkimin European 2023–2024

SIPAS VLERËSIMEVE TË RAPORTEVE TË KOMISIONIT EUROPIAN 2023 DHE 2024

KONTEKSTI

Komisioni European (KE) monitoron progresin dhe nivelin e përgatitjes së Shqipërisë në përmbushjen e kërkesave të anëtarësimit mbi një bazë vjetore. Vendi po punon për transpozimin e Acquis sipas Planit Kombëtar të Integritimit European (PKIE) i cili shërben si mjet për plotësimin e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA). Mbajtja e Konferencës së Parë Ndërqeveritare, më 19 korrik 2022 ishte një ngjarje historike për vendin tonë pasi mishëron aspektin teknik të procesit të integritimit në BE. Konferenca hapi rrugën për miratimin e kuadrit negociator të hartuar nga Komisioni European dhe fillimin e procesit screening. Me përfundimin me sukses të procesit screening në nëntor 2023, një tjetër hap me rëndësi u hodh në kuadër të procesit të integritimit, ai i hapjes së negociatave për Grupkapitullin 1 – Themeloret në tetor 2024.

Kjo Dëftesë mbi Progresin dhe Nivelin e Përgatitjes së Shqipërisë drejt anëtarësimit në BE merr si pikënisje gjendjen e përshkruar në Raportin e KE 2023 dhe pasqyron zhvillimin gjatë një viti, kristalizuar në Raportin e KE 2024. Ajo synon të shfaqë në një gjuhë më të lexueshme 1) Kriterin politik; 2) Kapitullin 23 (Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore) dhe 3) Kapitullin 24 (Drejtësia, Liria, Siguria).

Dëftesa paraqet një vlerësim për çdo nënçështje të secilit kapitull. Vlerësimi përfshin një shtjellim të progresit dhe përgatitjes gjatë periudhës së raportuar në raportin e KE 2023 dhe 2024 në secilën fushë, si dhe një vlerësim me notë (ku 10 është nota më e lartë dhe 4 më e ulët), ku merr parasysh terminologjinë e përdorur në çdo rast në Raportet e Komisionit European për progresin dhe nivelin e përgatitjes.

Për më tepër, merr në konsideratë shpeshtësinë me të cilën ajo është përdorur, kombinuar me rëndësinë e çështjes (për shembull, nismat e reja ligjore apo strategjitë përgjithësisht janë vlerësuar më të rëndësishme se trajnimet rutinë apo përmirësimet modeste në kapacitete). Fokus i veçantë i është dhënë vlerësimit të zbatimit të legjislacionit si një nga problemet më të rëndësishme që has vendi ynë. Metodologjia e aplikuar nga EMA përbën një fotografim të disa përbërësve që formësojnë një nënfushë, fushë e më pas kapitullin.

TERMINOLOGJIA E PËRDORUR PËR PROGRESIN	NOTA
Hapa mbrapa (Backsliding)	4
Mungon progresi (No progress)	5
Progres i kufizuar (Limited Progress)	6
Njëfarë progresi (Some progress)	7
Progres i mirë (Good Progress)	8–9
Progres shumë i mirë (Very good progress)	10

TERMINOLOGJIA E PËRDORUR PËR PËRGATITJEN	NOTA
n/a	n/a
Fazë e hershme (Early stage)	5
Njëfarë niveli përgatitje (Some level of preparation)	6
Njëfarë niveli/ Përgatitje mesatare (Some level / moderately prepared)	7
Përgatitje mesatare (Moderately prepared)	8
Nivel i mirë përgatitjeje (Good level of preparation)	9
Nivel i përparuar përgatitjeje (Well-advanced)	10

Si Duhet Lexuar Dëftesa?

Dëftesa e Shqipërisë paraqet notat për çdo fushë, në bazë të analizës nga Komisioni Europian për progresin dhe përgatitjen e bërë apo të munguar në procesin e integritetit evropian. Vlerësimi i fushave është realizuar duke marrë parasysh disa kritere si:

- Vlerësimi i përmbushjes së kërkesave dhe detyrimeve që burojnë nga procesi në kuadër të hartimit të legjislacionit.
- Vlerësimi i ecurisë së procesit duke u nisur nga gjetjet e raportit të vjetshëm me zhvillimet deri në publikimin e raportit të ri.
- Marrja parasysh ose jo e rekomandimeve të një viti më parë.

Nëpërmjet kësaj Dëftese, synohet t'u ofrohet aktorëve të shoqërisë civile, akademikëve, punonjësve të administratës, studentëve, bizneseve dhe çdo qytetari të interesuar një lexim i qartë dhe i saktë, përtej debateve politike i përparimit të Shqipërisë në të gjitha fushat pjesë të Kriteve të Kopenhagenit për anëtarësim në BE.

DËFTESA PËR KAPITULLIN 23 – GJYQËSORI DHE TË DREJTAT THEMELORE

KAPITULLI 23		RAPORTI I KOMISIONIT EUROPIAN 2023		RAPORTI I KOMISIONIT EUROPIAN 2024		NDRYSHIMI
Funksionimi i Gjyqësorit	Përgatitja – Nota: 8 Shqipëria ka një përgatitje mesatare sa i përket funksionimit të gjyqësorit. Ministria e Drejtësisë raporton rregullisht mbi zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025 dhe Planit të saj të Veprimit. Të gjitha institucionet gjyqësore kanë realizuar plane që të jenë të koordinuara me këtë strategji. Shqipëria duhet të sigurojë një koordinim të efektshëm mes institucioneve të drejtësisë. Shkolla e Magjistraturës duhet të rrisë përpjekjet e saj për të përmirësuar cilësinë e stafit akademik dhe të sigurojë procedura rekrutimi konkurruese dhe transparente. Cilësia e përgjithshme e trajnimeve të ShM ka nevojë për përmirësime të mëtejshme. Struktura e Specializuar Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), e përbërë nga Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit vazhdojnë të jenë funksionale. Cilësia e vendimeve të gjykatës ka nevojë për përmirësim. Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Gjykata e Lartë kanë marrë masa për unifikimin e praktikës gjyqësore e cila kërkon konsolidim të mëtejshëm. Procedurat e gjata, rritja e ngarkesës dhe akumulimi i dosjeve të mbartura kanë vazhduar të ndikojnë në eficientësinë e gjyqësorit dhe qasjen në drejtësi. Përpjekjet për të normalizuar akumulimin e çështjeve të mbartura nuk ka sjellë rezultate. Gjykatat më problematike janë Gjykata e Lartë, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Administrative e Apelit. Është e nevojshme që të forcohet ndërgjegjësimi i qytetarëve mbi zgjidhjet alternative të mosmarrëveshjeve. Ka filluar zbatim i hartës së re gjyqësore.	Përgatitja – Nota: 8 Shqipëria ka një përgatitje mesatare sa i përket funksionimit të gjyqësorit. Zbatimi i Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025 ka ende nevojë për përmirësim, pasi shkalla e zbatimit dhe kapaciteti i institucioneve gjyqësore përgjegjëse për të raportuar mbeten të ulëta. KLGJ dhe KLP janë funksionale, por efienca e tyre në emërimin, ngritjen në detyrë, transferimin dhe vlerësimin e magjistratëve është shumë e ulët. Bashkëndimi i tyre me Ministrinë e Drejtësisë, Inspektoriatin e Lartë të Drejtësisë (ILD) dhe institucione të tjera gjyqësore për politikat kyçe gjyqësore dhe ndjekjen e vazhdueshme të tyre deri te arritja e përfundimeve të zbatueshme gjithashtu mbetet e dobët. Procesi i vetting-ut ka vazhduar dhe pritet të përfundojë në shkallë të parë, që është një arritje e madhe, me 11 raste të mbetura nga 805 deri më 3 tetor 2024. Pavarësia dhe paanshmëria e gjyqësorit në gjykatat e larta, përfshirë gjykatat e apelit, kanë nivel të kënaqshëm, dhe kanë nevojë për përmirësim në gjykatat e shkallës së parë. Këshillat, ILD dhe ILDKPKI duhen të bëjnë përpjekje të mëtejshme për të siguruar kontrollin e pasurisë dhe të pastërtisë së figurës së magjistratëve dhe kandidatëve për magjistratë. Fakti që magjistratët e shkarkuar nga vetting-u nuk ndalohen të marrin pozicione si staf trajnues mbetet shqetësues. Harta e re gjyqësore është zbatuar, por cilësia dhe efikasiteti i drejtësisë ende përballen me sfida. Janë miratuar disa akte përgatitore për zbatimin e një sistemi të integruar të menaxhimit të çështjeve, por mungojnë fondet e nevojshme, veçanërisht për komponentin e gjykatave.	0			
	Progresi – Nota: 8 Është bërë progres i mirë me vazhdimin e zbatimit të reformës në drejtësi. Rivlerësimi gjithëpërfshirës kalimtar (vetting) i të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve ka vazhduar të përparojë me rezultate të mira. SPAK ka vazhduar me rezultatet, dhe ka realizuar hetime të çështjeve të përfshirjes së zyrtarëve të nivelit të lartë, ku janë dhe dy ish-ministra. Vazhdojnë të ngrihen shqetësime rreth përpjekjeve të supozuara për të ndërhyrë dhe ushtruar presion mbi sistemin gjyqësor. Është bërë progres në adresimin e hapësirave në gjyqësor ku janë emëruar një numër i konsiderueshëm magjistratësh të rinj (40). Një Drejtues i ri i SPAK u zgjodh në dhjetor 2022 pas një procesi bindës. Sistemi modern Informatik i Menaxhimit të Çështjeve ka qenë në pritje për tu zhvilluar për shumë vite dhe është i nevojshëm për të përmirësuar efikasitetin dhe transparencën e sistemit të drejtësisë. Është bërë progres në ngritjet e grupit të punës në qershor 2023, për hartimin e standardeve për sistemet e teknologjisë së informacionit në institucionet e sistemit të drejtësisë. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vazhduar të jetë funksional, dhe ka nisur dhe ka realizuar hetime disiplinore ndaj magjistratëve. Një plan solid zbatimi për hartën e re gjyqësore ende mungon dhe duhet të vihet në zbatim sa më shpejt.	Progresi – Nota: 7.5 Shqipëria ka shënuar njëfarë progresi në funksionimin e sistemit gjyqësor. Reforma në drejtësi dhe procesi i vetting-ut kanë vazhduar, duke sjellë përmirësime të rëndësishme në funksionimin e drejtësisë që duhen mbajtur. Funksionimi i kënaqshëm i ILD-së dhe progresi i mirë i vazhdueshëm në zbatimin e reformave në drejtësi kanë forcuar llogaridhënien. Më 21 tetor 2024, institucionet e vetting-ut kanë përfunduar 798 raste në shkallë të parë, që përfaqëson 99% të totalit. Përbërja e KLGJ-së dhe KLP-së u rinovua. Megjithatë, emërimi i anëtarëve jo-magjistratë në Këshilla është vonuar dhe mbetet ndjeshëm i ndikuar nga Parlamenti, duke treguar mangësi në verifikimin e pastërtisë së figurës dhe pasurisë, dhe në meritokracinë e procesit. KLP-ja ka kryer vetëm një vlerësim që nga fillimi i zbatimit të reformës në drejtësi të vitit 2016, çka është shqetësuese. Nuk është bërë progres i dukshëm në performancën e Shkollës së Magjistraturës për rishikimin e plotë të provimit të pranimit, për përditësimin e kurrikulave të trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm, dhe për cilësinë dhe integritetin e stafit të saj. Gjykatat po përballen me vonesa serioze në publikimin e vendimeve të arsyetuara brenda afateve ligjore.	-0.5			

KAPITULLI 23		RAPORTI I KOMISIONIT EUROPIAN 2023		RAPORTI I KOMISIONIT EUROPIAN 2024		NDRYSHIMI
Lufta kundër korrupsionit	Përgatitja – Nota: 7 Shqipëria ka njëfarë niveli përgatitjeje në luftën kundër korrupsionit. Shqipëria është pjesë e të gjitha konventave ndërkombëtare kundër korrupsionit, përfshirë dhe Konventën e OKB kundër Korrupsionit. Vettingu i anëtarëve të drejtësisë ka vijuar të sjellë rezultate pozitive në luftën kundër korrupsionit. Korrupsioni vazhdon të mbizotërojë në sektorët e shëndetësisë dhe pronave, si dhe brenda policisë. Kontrollët dhe hetimet e brendshme të administratës publike mbeten të dobëta dhe jo efektive. Ministrinë, të gjitha agjencitë në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, dhe 22 bashki kanë miratuar planet e vlerësimit të rrezikut të integritetit dhe planet e tyre të integritetit. Zbatimi i tyre efektiv mbetet që të sigurohet. Në përgjithësi, zbatimi i Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit vazhdon të jetë në rrugën e duhur, pavarësisht disa mangësive. Një strategji e re 2023–2030 po përgatitet.	Përgatitja – Nota: 7.5 Shqipëria është ndërmjet njëfarë niveli përgatitje/përgatitjeje mesatare. SPAK, që përbëhet nga Prokuroria e Posaqme (SPO), Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH) dhe gjykatat e specializuara, ka vijuar të japë rezultate pozitive në rastet e korrupsionit të nivelit të lartë. Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit (DPAK) përballet me sfida në efikasitetin e saj, pavarësisht kalimit të saj nën varësinë e Ministrisë së Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin. Verifikimi i plotë i pasurive, veçanërisht atyre të fshehura përmes marrëveshjeve të pronësisë me përfaqësim, pengohet nga kufizimet administrative të mandatit të ILDKPKI-së. Policia e shtetit mbetet e cënueshme ndaj korrupsionit dhe llogaridhënia vazhdon të jetë e dobët. Kuadri ligjor për luftën kundër korrupsionit është në thelb në fuqi, por nevojiten përmirësime në masat parandaluese dhe zbatimin e ligjit, veçanërisht në aspektet e koordinimit dhe përcaktimit të qartë të roleve institucionale për parandalimin e korrupsionit. Kjo përfshin fushat e konfliktit të interesit, financimin e partive politike, donacionet dhe sponsorizimet, mbrojtjen e sinjalizuesve, luftën kundër mashtrimit, si dhe sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve. Shqipëria duhet të adresojë sa më shpejt dhe në mënyrë efektive rekomandimet e mbetura të GRECO-s.	+0.5			
	Progresi – Nota: 7 Pavarësisht njëfarë progresi të bërë dhe përpjekjeve të vazhdueshme në luftën kundër korrupsionit, ku përfshihen dhe dënimet e disa zyrtarëve të nivelit të lartë korrupsioni mbetet një çështje shqetësuese. Rekomandimet e vitit 2022 janë zbatuar vetëm pjesërisht, çka do të thotë që mbeten ende në fuqi. Në mars 2023, GRECO doli në përfundimin se Shqipëria ka zbatuar në mënyrë të kënaqshme vetëm 5 nga 24 rekomandimet e dhëna. Masat kundër korrupsionit në fusha si: infrastruktura, pronat, dogana, administrata tatimore, arsimi, shëndetësia, prokurimet publike, kontratat PPP etj. vazhdojnë të kenë një ndikim të kufizuar. Është bërë njëfarë progresi në përpjekjet për informimin dhe ndërgjegjësimin kundër korrupsionit, por duhet që ato të jenë më të qëndrueshme.	Progresi – Nota: 7 Shqipëria ka shënuar njëfarë progresi në përpjekjet kundër korrupsionit. Kapaciteti i SPAK–ut në hetimet financiare është rritur, dhe përdorimi i rregullt i hetimeve financiare dhe konfiskimeve të aseteve është përmirësuar. Një rezultat tjetër i drejtpërdrejtë i procesit të vetting–ut u regjistrua në shtator, kur Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) dërgoi 19 raste rivlerësimi me elemente kriminale të dyshuara për ndjekje gjyqësore në SPAK. Miratimi i një ligji për dhënie amnistie gjerësisht bëri që 40 individëve të dënuar nga gjykatat e SPAK–ut të falen plotësisht dhe 65 të tjerë përfituan ulje dënimi, çka ngre shqetësime. Prokuroria e Përgjithshme dhe policia e shtetit ende përballen me sfida në identifikimin dhe hetimin efektiv të korrupsionit. Numri i raportimeve nga sinjalizuesit mbetet i ulët. Vlerësimet e synuara të riskut dhe masat e dedikuara janë të nevojshme për të adresuar korrupsionin në sektorët më të cënueshëm, përfshirë policinë, doganat, menaxhimin e tokave dhe pasurive, kadastrën shtetërore dhe prokurimin publik.	0			

KAPITULLI 23		RAPORTI I KOMISIONIT EUROPIAN 2023		RAPORTI I KOMISIONIT EUROPIAN 2024		NDRYSHIMI
Të drejtat e njeriut	Përgatitja – Nota: 7 Protokolli Fakultativ i Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Protokolli Fakultativ i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore nuk janë nënshkruar ende. Avokati i Popullit vazhdon të promovojë dhe forcojë zbatimin e të drejtave të njeriut në mënyrë të kënaqshme. Në lidhje me parandalimin e torturës dhe keqtrajtimit, niveli i cilësisë së stafit nëpër spitalet e burgjeve është i kënaqshëm. Pavarësisht, objektet vazhdojnë të kenë kushte të këqija dhe mangësi strukturore. Legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të përafrohet menjëherë me Rregulloren e Përgjithshme të BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave dhe direktivën përkatëse të "zbatimit të ligjit". Duhet të merren masa të menjëhershme për të parandaluar shkeljet masive të përsëritura të të dhënave personale dhe të përmirësohet menaxhimi i tyre. Fakti që martesat e fëmijëve vazhdojnë ende, është një çështje shqetësuese, edhe pse qeveria që nga 2021 e ka prioritizuar këtë çështje duke e buxhetuar në kuadrin kombëtar të politikave.	Përgatitja – Nota: 7 Kuadri ligjor i Shqipërisë ofron një bazë përgjithësisht të mirë për mbrojtjen e të drejtave themelore. Shteti nuk ka nënshkruar Protokollin Fakultativ të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore. Shqipëria duhet të zhvillojë një sistem të plotë monitorimi dhe mbledhjeje të të dhënave për të vlerësuar nivelin e zbatimit të legjislacionit, politikave dhe strategjive për të drejtat e njeriut. Shteti përballet me sfida në implementimin e vendimeve të GJEDNJ-së. Aktualisht, 16 raste janë nën mbikëqyrje të thelluar nga Komiteti i Ministrave, më shumë se dyfishi i numrit të vitit 2023 (7 raste). Avokati i Popullit ka vijuar të ushtrojë mandatin e tij në mënyrë të kënaqshme, megjithatë, mungesa e stafit vazhdon të ndikojë në funksionimin e zyrave të tij rajonale. Kushtet për të burgosurit me probleme shëndetësore mendore dhe pacientët mjeko-ligjor janë një shqetësim i madh për shkak të mbipopullimit, mungesës së stafit mjekësor dhe terapistëve, si dhe infrastrukturës së papërshtatshme. Vazhdon të ketë problematika lidhur me trajtimin e të dhënave personale nga kompanitë private dhe administratat publike, si dhe për dobësitë e sistemeve informatike të qeverisë. Kapaciteti i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale duhet të fuqizohet.	0			
	Progresi – Nota: 7.5 Në përgjithësi, Shqipëria është pjesë e shumicës së instrumenteve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Shqipëria vazhdon të ketë bashkëpunim të mirë me Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut. Është bërë progres i kufizuar në hetimin e rasteve dhe forcimin e kuadrit institucional dhe legjislativ për personat e zhdukur që nga koha e komunizmit. Pranë avokati të popullit nuk është raportuar asnjë rast keqtrajtim sistematik prej policisë apo nëpër burgje. Sistemi i burgjeve dhe i qendrave të ndalimit mbetet një çështje serioze shqetësuese. Janë transferuar në burgun e Lezhës, pacientët e ndaluar që qëndronin në qendrat e ndalimit në Krujë dhe Zahari, duke zbatuar kështu rekomandimin e vitit 2021 të Komitetit Europian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin Çnjerëzor e Degradues ose Ndëshkues, si dhe vendimet e GJEDNJ. Është bërë progres në përdorimin e dënimeve alternative, në veçanti atë të shërbimit të provës. Në përgjithësi, liria e mendimit, ndërgjegjes dhe besimit është mbrojtur. Rikthimi i pronave të komunitetet fetare, të mara pa të drejtë gjatë regjimit të diktaturës mbetet një çështje e pazgjidhur.	Progresi – Nota: 7.5 Shqipëria është palë nënshkruese në instrumentet kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Gjatë kësaj periudhe raportimi, është bërë progres në miratimin e një strategjie të re për mbrojtjen e viktimave të krimit, si dhe rezultatet paraprake të regjistrimit kombëtar të popullsisë dhe banesave, të publikuara në qershor. Shqipëria vazhdon të sigurojë bashkëpunim të mirë me GJEDNJ-në. Gjykata ka konstatuar shkelje të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, kryesisht në lidhje me të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare, të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të drejtën për liri dhe siguri. Shqipëria, në përgjithësi, i përmbush detyrimet e saj lidhur me ndalimin e torturës dhe keqtrajtimit. Funksionimi i Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) është në nivel të kënaqshëm, megjithatë, procesi pasues për zbatimin e rekomandimeve të tij mbetet i ulët. Pavarësisht njëfarë progresi, korrupsioni, kujdesi shëndetësor në nivel të dobët dhe mungesa e stafit në sistemin penitenciar dhe qendrat e paraburgimit mbeten problematike. Shërbimi i provës është funksional dhe siguron mundësi alternative ndaj burgosjes, përfshirë për të miturit që kryejnë vepra penale. Duhet të intensifikohen përpjekjet për zbatimin e masave në përgjithësi, veçanërisht në fushat e dhunës ndaj grave, mbrojtjes së të drejtave të pronës dhe të drejtat e pakicave kombëtare.	0			

KAPITULLI 23		RAPORTI I KOMISIONIT EUROPIAN 2023		RAPORTI I KOMISIONIT EUROPIAN 2024		NDRYSHIMI
Liria e shprehjes	Përgatitja – Nota: 6.5 Shqipëria ka njëfarë niveli përgatitjeje/ përgatitje mesatare në fushën e lirisë së shprehjes. E drejta kushtetuese e lirisë së shprehjes vazhdoi të respektohej në përgjithësi. Është thelbësore që çdo ndryshim i kornizës ligjore të jetë i përputhshëm me standardet europiane dhe t'i nënshtrohet konsultimeve gjithëpërfshirëse me organizatat e mediave dhe shoqërinë civile. Dispozitat e Kodit Penal mbi fyerjen dhe shpifjen duhet të shfuqizohen ose të jenë tërësisht në përputhje me standardet europiane. Siguria e kufizuar në punë dhe kushtet e këqija të punës paraqesin një rrezik të lartë për vetëcensurën. Shqipëria është nënshkruese e Deklaratës për të Ardhenen e Internetit të prillit 2022. Strategjia kombëtare për sigurinë kibernetike dhe plani i saj i veprimit 2020–2025 është zbatuar. Strategjia përfshin një kapitull mbi mbrojtjen e fëmijëve në internet si një përparësi për vendin. Shteti në përgjithësi shmang filtrimin dhe bllokimin e përmbajtjes në internet. Mediat dixhitale vazhdojnë të ndikohen fuqishëm nga aktorët politikë, bizneset dhe nga palët e treta në lidhje me financimin dhe përmbajtjen. Platformat e mëdha të teknologjisë së informacionit mbeten të parregulluara dhe të paregjistruara në Shqipëri. Liria e shprehjes artistike është gjerësisht e garantuar. Ligjet mbi gjuhën e urrëjtjes janë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Nevojitet zbatimi në nivel më të mirë dhe rritja më e madhe e ndërgjegjësimit për të eliminuar gjuhën e urrëjtjes, kryesisht në zonat rurale dhe të largëta.	Përgatitja – Nota: 6.5 Shqipëria ka njëfarë niveli përgatitjeje/ përgatitje mesatare në fushën e lirisë së shprehjes. Kuadri për mbrojtjen e gazetarëve është në fuqi, por sulmet verbale dhe fizike, si dhe fushatat shpifëse, kanë vazhduar. Përdorimi i padive strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP) është rritur në 73 raste të raportuara në 2023 (nga 42 raste në 2022). Kodi Penal nuk parashikon mbrojtje të veçantë për gazetarët kundër dhunës, sulmeve apo kërcënimeve gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. Ligji për të drejtën e informimit është gjerësisht i përputhshëm me standardet europiane; megjithatë, duhet të vendosen afate më të shkurtra dhe detyruese për përgjigjet ndaj gazetarëve, bazuar në praktikën më të mira europiane. Në prill të vitit 2024, Parlamenti miratoi një komitet parlamentar <i>ad hoc</i> për trajtimin e dezinformimit dhe ndërhyrjes së huaj, pa mbështetje nga opozita. Pavarësia e medias vazhdon të ndikohet negativisht nga pleksja e interesave politike dhe të bizneseve në lidhje me financimin dhe përmbajtjen, si dhe përqendrimin e lartë të pronësisë së medias. Kapaciteti i sigurisë kibernetike i kanaleve mediatike është në përgjithësi i dobët. Gjatë periudhës së raportimit janë shënuar disa sulme kibernetike ndaj mediave. Gazetarët përballesh me vështirësi të mëdha në lidhje me burimet financiare dhe njerëzore të kufizuara dhe mundësinë e pamjaftueshme për të krijuar bashkëpunim efektiv me qeverinë për të promovuar interesat e mediave të pavarura.	0			
	Liria e Shprehjes	Progresi – Nota: 5.5 Është bërë progres i kufizuar, kryesisht përmes ndryshimit të Ligjit për mediat audiovizive, për të qenë i përafëruar me Direktivën e BE-së të vitit 2018 për shërbimet e mediave audiovizive. Atmosfera e sulmeve verbale, fushatave shpifëse dhe akteve të frikësimit ndaj gazetarëve nuk është përmirësuar. Paketa ligjore kundër shpifjes u hoq nga rendi i ditës së Parlamentit në nëntor të vitit 2022. Autoriteti i Medias Audiovizive miratoi një Kod të rishikuar të Transmetimeve Audiovizive. Grupet e biznesit të profilit të lartë e rritën më tepër përfshirjen e tyre ekonomike në tregun mediatik. Përqendrimi i tregut dhe audiencës dhe mungesa e transparencës së financimit të medias vazhdojnë të mbeten çështje shqetësuese lidhur me lirinë e medias në vend.	Progresi – Nota: 5 Shqipëria nuk ka bërë progres në këtë fushë. Ende nuk është krijuar një historik i qëndrueshëm i adresimeve për sa i përket ndjekjes penale dhe pasojave gjyqësore me qëllim mbrojtjen e sigurisë së gazetarëve. Nuk është arritur asnjë progres në përafrimin e kuadrit ligjor me <i>acquis</i> e BE-së, përfshirë Ligjin për Lirinë e Medias, as në trajtimin e përqendrimit të lartë të tregut dhe transparencës së pronësisë së mediave. Zbatimi i Ligjit për të drejtën e informimit është i dobët, për shkak të vonesave në përgjigje. Ligji për mediat audiovizive parashikon mbrojtje të kufizuar ndaj përqendrimit të pronësisë së medias dhe monopoleve. Shteti përgjithësisht shmang filtrimin dhe bllokimin e përmbajtjes online. Megjithatë, organizatat për lirinë e medias pretendojnë se nuk ka dispozita ligjore të veçanta për të përforcuar neutralitetin e rrjetit.	-0.5		

KAPITULLI 23		RAPORTI I KOMISIONIT EUROPIAN 2023		RAPORTI I KOMISIONIT EUROPIAN 2024		NDRYSHIMI
Barazia gjinore / mosdiskrimin imi	Përgatitja – Nota: 6 Dispozitat për mekanizmat e referimit ndërmjet niveleve të ndryshme të kujdesit, trajnimit të ofruesve të ndihmës mjekësore, shërbimet miqësore ndaj të rinjve dhe kontakti me grupet e prekshme nuk janë trajtuar në Ligjin mbi shëndetin riprodhues. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030 dhe plani i saj i veprimit janë më pohues në trajtimin e të gjitha të drejtave të grave dhe burrave. Megjithatë, zbatimi duhet të përshpejtohet. Gratë që jetojnë në zonat rurale dhe të largëta, gratë të komunitetit egjiptian dhe rom dhe LGBTIQ-të përballen me qasje të kufizuara në kujdesin shëndetësor parësor dhe në shërbimet e kujdesit shëndetësor seksual dhe riprodhues. Shërbimet sociale vazhdojnë të jenë të varura nga donatorë dhe shpesh ofrohen nga organizata të shoqërisë civile. Një buxhet shtetëror i dedikuar dhe burime të tjera janë ende të nevojshme. Kuadri ligjor dhe i politikave mbi të drejtat e fëmijës reflekton në nivel më të lartë standardet ndërkombëtare dhe kërkesat e BE-së. Axhenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026 ka një kuadër strategjik, në përputhje me angazhimet kombëtare dhe ndërkombëtare. Në vitin 2022, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vazhdoi të trajtojë një numër të qëndrueshëm çështjesh, kryesisht në fushën e punësimit dhe shërbimeve. Parada e Krenarisë së 12-të në Tiranë u zhvillua në mënyrë paqësore më datë 20 maj 2023. Sidoqoftë, ndërgjegjësimi i publikut dhe pranimi i personave të komunitetit LGBTIQ mbetet i ulët, veçanërisht në zonat rurale. Në mars 2023, qeveria njoftoi pezullimin e nismave të lidhura me krijimin e skemës së shtetësisë për investitorët. Shqipëria duhet të shmang zhvillimin e një skeme të tillë që do të shfaqte rreziqe në lidhje me sigurinë, pastrimin e parave, evazionin fiskal, financimin e terrorizmit, infiltrimin nga krimi i organizuar dhe nuk përputhet me Acquis e BE-së.	0				
Barazia gjinore / mosdiskrimin imi	Progresi – Nota: 6 Për dhunën me bazë gjinore, kuadri ligjor kombëtar duhet të harmonizohet më tej me dispozitat e Konventës për Dhunën dhe Ngacmimin në Botën e Punës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës, ratifikuar në shkurt 2022. Kuadri ligjor i tanishëm nuk është tërësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke përfshirë Konventën e Stambollit, dhe i mungon përqendrimi në riintegrimin dhe qasjen në shërbime për viktimat dhe të mbijetuarit e dhunës. Është realizuar njëfarë progresi në të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Legjislacioni kuadër i Shqipërisë për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara mbetet vetëm pjesërisht në përputhje me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe boshllëqet duhet të trajtohen. Shqipëria duhet të ratifikojë Protokollin Fakultativ të Konventës. Zbatimi i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor ka vazhduar të përmirësohet. Në shoqërinë shqiptare, diskriminimi i komunitetit LGBTIQ është ende shumë i përhapur. Është bërë progres i kufizuar në përfshirjen sociale të minoriteteve rome dhe egjiptiane. Nuk ka pasur zhvillime të reja, sa i përket të drejtave të shtetësisë.	0				
	Përgatitja – Nota: 6 Kuadri ligjor dhe institucional për barazinë gjinore është pjesërisht i përafëruar me acquis e BE-së. Disa mangësi mbeten në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030 dhe Planit të saj të Veprimit. Aplikimi i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor vazhdoi në vitin 2023, me 48 nga 75 programet buxhetore në 11 ministritë e linjës dhe institucionet qendrore. Avokati i Popullit krijoi “Observatorin e Feminicidit” për të raportuar dhe monitoruar rastet e feminicidit. Shërbimet mbështetëse për viktimat e dhunës vazhdojnë të jenë të varura nga donatorët dhe të pamjaftueshme, veçanërisht në sektorin e kujdesit shëndetësor, financimin e strehave sociale, ndihmën juridike falas dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës. Në vitin 2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi trajtoi gjashtë raste të gjuhës së urrejtjes, duke e konfirmuar atë në dy prej tyre. Në vitin 2024, dy raste të reja janë në shqyrtim. Mekanizmat e koordinimit duhet të përmirësohen ndjeshëm në trajtimin e çështjeve si trafikimi i fëmijëve, krimi kibernetik, martesave të fëmijëve, abuzimit seksual të fëmijëve dhe të drejtës për kujdes shëndetësor dhe arsim. Cilësia e arsimit për fëmijët me aftësi të kufizuara, veçanërisht për fëmijët me dëmtim të dëgjimit, mbetet shqetësuese. Shqipëria ende nuk ka legjislacion për njohjen e bashkëjetesës civile apo martesave të së njëjtës gjini, dhe zbatimi i Planit Kombëtar të Veprimit për LGBTIQ 2021-2027 mbetet i paplotë. Një Strategji e re Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030 u miratua me një vendim të Këshillit të Ministrave. Komiteti Këshillimor i Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare vuri në dukje se minoritetet kombëtare kanë mundësi të kufizuara për përfaqësim politik, veçanërisht në nivel kombëtar, dhe rekomandoi rishikimin e procedurave për përzgjedhjen e anëtarëve të Komitetit të Minoriteteve Kombëtare. Në përgjithësi, qasja në arsim për komunitetin rom vazhdon të jetë problematike, dhe profili i përjashtimit shoqëror të tyre në shkolla mbetet një çështje e pazgjidhur.					